

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

24.02.2025

Ora 11:08

**RENDI I DITËS**

**Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 2, depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimi i pikës nr. 1 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z. K. Bele, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Përfaqësues nga Kuvendi

**Z. I. Rusmali:** Çelim seancën paraprake për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.2, të Kuvendit të Shqipërisë kundër vendimit nr. 117, datë 19.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Prezent në këtë seancë janë anëtarët e KAS-it në përbërje të plotë, janë përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konkretisht zonja Ina Osmanaj dhe janë përfaqësuesit të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët i ftoj të prezantohen për efekt të procesverbalit.

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Përshëndetje unë jam Antonela Veshi, këshilltare pranë Shërbimit Legjislativ, me autorizim për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë.

**Znj. K. Rusi, përfaqësuese e Kuvendit:** Përshëndetje unë jam Kesiana Rusi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë, këshilltare në Shërbimin Legjislativ.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit shumë! Fillimisht nëse keni ndonjë kërkesë paraprake, si palë në proces, keni të drejtë ta bëni tani. Kryesisht ky moment është për kërkesa që kanë lidhje me pretendime në raport me trupën e KAS-it, për konflikt interesi ose ndonjë gjë të ngjashme. Nuk keni? Mirë. Seanca e sotme është seancë e kontrollit formal të ankimit, ne shqyrtojmë legjitimitimin e ankuesit, shqyrtojmë respektimin e afatit ligjor për ankimin dhe kompetencën e KAS-it për të marrë në shqyrtim ankimin. Do ta filloja me ju, administratën për një prezantim të shkurtër të konstatimeve të administratës lidhur me këto elementë të formës, pastaj ia japim fjalën përfaqësuesve të Kuvendit.

**Znj. I. Osmanaj:** Faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka administruar nga KRIIK-u një denoncim, regjistruar me numër regjistri 6 ID, në datën 11.02.2025. në këtë denoncim KRIIK-u pretendon se në datën 23 dhjetor 2024 në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i propozuar nga z. Nasip Naço, deputet. Ky projektligj, KRIIK-u pretendon se është duke diskutuar në komisione dhe pritet të miratohet në seancën e ardhshme plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji ofron përfitime të drejtpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht atyre që vuajnë dënimin në vend. Ai ofron rregullime të kuadrit ligjor, duke u dhënë mundësi më të shpejtë të dënuarve të kalojnë në institucion të një niveli më të ulët të sigurisë përfshirë këtu dhe të dënuarit pranë institucioneve të sigurisë të lartë. Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ me vendimin nr.101 administrata e KQZ-së në kuadër të hetimit administrativ të paraqisnin pretendimet Kuvendi në datë 17.02.2025 dhe nga Kuvendi kemi administruar pretendimet se në datën 28.01.2025 u shqyrtua projektligji, amendimet e propozuara synojnë menaxhimin dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

funksionimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Komisioneri pasi hetoi administrativisht dhe shqyrtoi këtë projektligj me vendimin nr.117, datë 19.02.2025 në pikën e parë të tij vendosi t'i rekomandojë Kuvendit të Shqipërisë të mos përshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe dënimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" 21.02.2025 kemi administruar kërkesën ankimore nr. 2 për ankimin, pikës 1, të vendimit nr.117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Konstatojmë se ky ankim është në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe e lëmë në çmim të KAS-it për ta kaluar në seancë të shqyrtimit. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit Ina! Opinioni i përfaqësuesve të Kuvendit, thuajeni me mikrofon, ju lutem!

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve! Në lidhje me kërkesën paraprake ne si Kuvend, referuar parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative, konkretisht nenit 117, germa "b" dhe "c" të nenit 117 të tij kërkojmë pavlefshëmrinë, jo vetëm të pikës 1 të vendimit nr.117 por të gjithë vendimit, për shkak se jemi në kushtet e pasaktësisë juridike dhe pavlefshmërisë të të gjithë aktit për dy arsye. Së pari në formë dhe në përmbajtje, pasi vetë objekti i vendimit nr. 117 bie në kundërshtim me sa është parashikuar në pikën 2, të vendimit nr.117 të Komisionerit Shtetëror dhe së dyti jemi në kushtet e tejkalimit të kompetencave për sa kohë që për të dyja këto projektligje të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi KAS-i është shprehur me vendimmarrje përpara fillimit të shqyrtimit administrativ nga ana e Komisionerit. Këto janë kërkesat tona.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Kujt i referoheni ju me fjalinë “KAS-i është shprehur me vendimmarrje”?


**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Atëherë i referohem pikërisht projektligjit “Për paketën e maleve” dhe gjithashtu projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92, datë 24.07.2014”, për të cilin njëkohësisht ka pasur dy nisma deputetësh por tek vendimi nuk është specifikuar konkretisht se cilës nismë i referohet.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Teksti që ju keni konsultuar për të bërë ankimin, ka pasur një lapsus dhe lapsusi është korrigjuar ndërkohë. Vendimi është i publikuar me korrigjim të lapsusit, domethënë, pa këtë pikën 2, në mos gaboj apo jo? Nuk e ka këtë pikën 2 vendimi.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë në pikën 2 sipas aktit të korrigjuar është “I rekomandoj Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerë e shtuar”, propozuar nga z. Agron Duka. Ndërkohë në seancën për kërkesën ankimore nr.1, KAS-i ka shqyrtuar projektligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” propozuar nga z. Erion Braçe. Pra kemi dy projektligje të ndryshme, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në këtë rast kemi një projektligj të propozuar nga një deputet tjetër.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kjo saktëson përmbajtjen e dispozitivit të vendimit dhe prapëseprapë lë në fuqi kërkesën tuaj për pavlefshmëri absolute të aktit?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Atëherë dhe në parashtrimet e mija nuk iu referova vetëm formës po dhe përmbajtjes sepse edhe në përbërje të vendimit Komisioneri në argumentet e tij i referohet një projektligji të ndryshëm nga ai i parashikuar në objekt dhe konkretisht thotë se: “Konstatohet se fusha e veprimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92 datë 24.07.2014” me ndryshimet e propozuara sjell një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik, tregtar. Çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale” dhe ne mendojmë se këto pasaktësi juridike mund të kenë ndikuar gabimisht edhe në vendimmarrjen e Komisionerit për sa i përket parashikimeve të aktit për të cilin ka dhënë mendimin.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, ne do t’i futemi përmbajtjes, kur të kemi seancën, po duhet të fiksojmë, jemi përpara një modifikimi të objektit të kërkesës ankimore. Tashmë nuk kërkohet shfuqizimi i pikës 1, po kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit. Ju jeni, domethënë ju nuk keni ndonjë pretendim në raport me elementët e formës, ju legjitimoheni kërkesën tuaj, jeni të sigurtë për këtë, keni bërë kërkesën në afatin e caktuar nga ligji dhe jeni të bindur që kërkesa për pavlefshmërinë absolute të aktit mund t’i paraqitet këtij komisioni, se ky komision e ka këtë kompetencë. Lidhur me ndryshimin e objektit të kërkesës, Ina keni ndonjë reflektim tjetër apo nuk keni çfarë thoni lidhur me këtë?

**Znj. I. Osmanaj:** Ndoshta te deklaratimet që bëri përfaqësuesja e Kuvendit, duhet të citonte që në brendësi të vendimit të Komisionerit citohet që: “Ky projektligj është i propozuar nga z. Agron Duka” sepse nuk u citua.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord, do ta shqyrtojmë në seancë.

**Znj. I. Osmanaj:** Dakord, gjë tjetër jo.

**Z. I. Rusmali:** Argumentat do t'i rrahim në seancë, por ne duhet të fiksojmë këtu që kemi ndryshim të objektit të kërkesës apo jo? Dakord. Kemi një pyetje për ju si përfaqësues të Kuvendit. Kërkesa juaj ankimore është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm, ka tagër përfaqësimi në emër të Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm? Duhet të jetë Kryetari i Kuvendit që përfaqëson me të tretët apo mund ta bëjë këtë gjë Sekretari i Përgjithshëm? Po, besoj e dinë zonjat.

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Unë mendoj që në mbështetje të detyrave funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm dhe gjithashtu të urdhrit të Kryetares së Kuvendit nr. 52, datë 1.08.2024 “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë” botuar dhe në Fletoren Zyrtare me numër 136, datë 5.08.2024, Sekretari i Përgjithshëm, jo vetëm në këtë rast por në çdo rast ka tagrin për të përfaqësuar, për të deleguar përfaqësimin pranë Shërbimit Legjislativ dhe konkretisht në rang drejtori ose këshilltari.

**Z. I. Rusmali:** Urdhri?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Urdhri nr. 52, datë 1.08.2024 “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, është i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 136, datë 5.08.2024.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord do të thotë ne mund ta nxjerrim nga Fletorja Zyrtare dhe ta konsultojmë sipas nevojës. Pyetje tjetër prapë që ka lidhje me, po këtë herë për administratën. Në vendimin e Komisionerit është pasqyruar si palë vetë zonja Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendi i Shqipërisë si palë e interesuar, zonja Elisa Spiropali dhe zoti Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, vendimi vetë siç e kuptova unë, e para subjektet nuk kanë qenë pjesë e shqyrtimit administrativ apo jo? Kanë ardhur vetë, kanë dërguar njeri?

**Znj. I. Osmanaj:** Në seancën e shqyrtimit të KAS-it po, kanë qenë përfaqësues të Kuvendit, ka qenë zonja Mimoza Arbi, e cila ka folur në lidhje me çështjen.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kanë përfaqësuar Kuvendin, palë e interesuar, po jo zonjën Spiropali si person dhe asnjëri tjetër zotin Agaçi si person.

**Znj. I. Osmanaj:** Ka ardhur në cilësinë e përfaqësueses së Kuvendit.

**Z. I. Rusmali:** Ndërkohë që në kërkesë ankimore ju si Kuvend e keni vendosur zonjën Spiropali, prapë në cilësinë e vet individuale si subjekt të çështjes. Vendimi vetë, aq sa pashë unë, nuk shpreh asgjë për zonjën Spiropali, as për zotin Agaçi, asgjë! As i analizon përgjegjësi ligjore të tyre dhe as vendos detyrime ndaj tyre. Në një farë mënyre ata janë përmendur si palë, po pa pasur asnjë lidhje me shqyrtimin sepse hetimi administrativ që është konkluduar në vendimmarrje nuk ka përcaktuar asnjë gjë këtyre personave. Mos duhet të bëjmë një korrigjim të këtij elementi të kërkesës, në qoftë se ju gjykoni që ka vend për ta hequr zonjën Spiropali nga kërkesa?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. K. Bele:** Për analogji pse është Engjëll Agaçi dhe nuk është Edi Rama për shembull?

**Znj. I. Osmanaj:** Sepse te vendimi nr. 9 përcaktohet që person përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të vendimit nr. 9 është Sekretari i Përgjithshëm, në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm është Drejtori i Drejtorisë ose...

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Pse nuk është Genc Gjonçaj? Pse nuk mbani të njëjtin qëndrim apo kanë lidhje me zonjën Spiropali?

**Z. I. Rusmali:** Jo se është Kryetari i Kuvendit, ka të drejtë ajo është Kryetari i Kuvendit përgjegjës për zbatimin e ndalimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave përgjegjës për zbatimin e ndalimeve.

**Z. K. Bele:** Kam dhe një pyetje që ndoshta s'ka lidhje, thjesht për të më ndihmuar mua të kuptoj. Vjen rekomandimi i Komisionerit, se dikush nga ju ishte në Komision të Ligjeve, pra ka ardhur rekomandimi është bërë publik, jeni vënë në dijeni, ju çfarë akti ndërmerrni? Se ai është rekomandim, pra merrni një vendim në mbledhje, merr një vendim kryetari i komisionit, çfarë pasojash sjell “de facto”, po themi dhe “de jure”? Si operohet në komision, nëse e dini ju?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Në fakt nuk isha përgatitur për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, gjithsesi në aspektin dhe të opinionit tim personal...

**Z. K. Bele:** Po, çështje fakti...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:**...nëse i përgjigjem kësaj pyetje duhet të bëjmë dhe një analizë nëse realisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të monitorojë kalendarin e punimeve të Kuvendit së pari dhe për këtë duhet ndoshta një analizë dhe ne si shërbim. Këtu po jap mendimin tim si juriste prej 11 vitesh në Kuvendin e Shqipërisë. Tani unë nuk do citoj si ndalon Kuvendi po citoj ndalesat që ka Kodi Zgjedhor, që konkretisht thotë “Katër muaj përpara zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re”. Jo, më duhet të bëj një hyrje të vogël për të sqaruar, është thjesht dhe konkretisht Kodit thotë: “Ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja” dhe në asnjë moment nuk shprehet për shqyrtimin, faza e shqyrtimit në komisione parlamentare jo në çdo rast mund të konkludohet me miratim të aktit. Në opinionin tim, rekomandimi i Komisionerit mund të ndalojë fazën e miratimit në seancë plenare por jo atë të shqyrtimit në komisionet parlamentare sepse fazë e shqyrtimit tek ne janë edhe konsultimet që bëjmë.

**Z. K. Bele:** S’ma kuptove pyetjen, kjo do të diskutohet në themel, unë po pyes konkretisht kur vjen opinioni i Komisionerit dhe i bëhet e ditur Kryetarit të Kuvendit, Kuvendi, projektligji x, abstragojmë është në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese apo Komisionin e Ligjeve, nuk e di apo në të gjitha Komisionet, çfarë ndodh në komision? Si vendos komisioni, ta pezullojë apo s’vendos asgjë, thjesht pret, s’e kuptoj?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Deri tani nuk kemi parë asnjë praktikë personalisht, kështu që nuk mund t’i përgjigjem në mënyrë të saktë dhe përfundimtare pyetjes tuaj, do të shohim do të ketë vendimmarrje të Komisionit në lidhje me sugjerimin.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord, faleminderit! Tani, për ta ndihmuar ndoshta procedurën, e keni mundësinë ju, siç thonë kolegët, urdhri respektiv i Kryetares së Kuvendit nuk ka lidhje me procedurat pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka lidhje me procedurat e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese, por ne jemi strukturë administrative, nuk kemi pse t'i bëjmë gjërat shumë të komplikuara për asnjërën palë. Ne nuk presim që të dalë një urdhër i ri dhe të botohet në Fletoren Zyrtare pastaj, por është pritshmëri normale për shembull që ju të bëni disa korrigjime të kërkesa juaj ankimore. Për shembull kërkesa ankimore të nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit, që ka tagrin e përfaqësimit zyrtarisht, mund të rregulloni objektin siç e kërkuat këtu, e treta të hiqni zonjën Spiropali, Kryetaren e Kuvendit nga lista e subjekteve që kanë lidhje me këtë kërkesë ankimore sepse vendimi në vetvete nuk përmban asnjë detyrim për Kryetaren e Kuvendit dhe është edhe në objektin e kërkesës tuaj drejtuar KAS-it që ju të keni pretendime lidhur me përgjegjësi të Kryetares së Kuvendit në raport me çëshjen, sikur të ishte kështu ju do të kishit të drejtë që të thërrisnit në kauzë Kryetaren e Kuvendit, zonjën Spiropali. Po ju nuk jeni në atë linjë, ju jeni në linjën e kundërt, ju kërkonit pavlerfshmërinë e vendimit dhe këtë mund ta bëni edhe si Kuvend i Shqipërisë, në të drejtën tuaj si palë e kësaj procedure. Mund t'i bëjmë këto korrigjime ne? Sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht sot dhe pastaj ju vini në seancë edhe me një autorizim, siç bëhet zakonisht nga institucionet për ju që si persona të autorizuar për të përfaqësuar Kuvendin në shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore. Besoj janë që të gjitha gjërat që janë të mjaftueshme për të ecur përpara. Ka ndonjë gjë që mund ta kërkojmë ne? Po zoti Braho.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. L. Braho:** Kemi një kopje këtu të projektligjit që është propozuar nga zoti Naço është ky versioni përfundimtar, se ka një shënim këtu në seancë plenare, është ky versioni përfundimtar që do të shkojë në seancë plenare? Këtë e keni sjellë ju?

**Z. I. Rusmali:** Projektligji i depozituar është në atë formë, ai është diskutuar vetëm në një komision, në komisionin që jep mendim por nuk është diskutuar për komisionin përgjegjës, do të thotë nuk është i gatshëm për t'i shkuar seancës, është nisma.

**Z. L. Braho:** Kjo është nisma e zotit Naço?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Përgjigja e pyetjes, a është kjo nisma e zotit Naço? Unë thashë po, nisma është ajo.

**Z. L. Braho:** Jo, unë shoh këtu shënimin “seancë plenare”, se nuk e di si funksionon procedura aty brenda. Tani në fazën që jemi sot ka ndonjë amendim rreth kësaj nisme?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Në fazën që jemi sot, projektligji ka kaluar shqyrtimin vetëm në komisionin për dhënie mendimi që është Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.

**Z. I. Rusmali:** Cili ka propozuar amendamente në tekst?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Ka bërë vetëm një sugjerim për komisionin përgjegjës në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. L. Braho:** S'qenka projektligj...

**Z. I. Rusmali:** Po jo amendament.

**Z. L. Braho:** Çfarë propozimi ka bërë?

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Sugjerimi ka qenë që hyrja në fuqi të bëhet në çfarëdo periudhe por mbas zgjedhjeve të 11 majit dhe ia ka lënë riformulimin si detyrë komisionit përgjegjës.

**Z. L. Braho:** Komisioni përgjegjës është komisioni?


**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Komisioni përgjegjës është Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

**Z. L. Braho:** Dakord.

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka filluar, është hapur prezantimi i ligjit por as miratimi në parim dhe as shqyrtimi nën për nen.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, biem dakord që ju do t'i reflektoni në tekstin tuaj këto gjërat që thamë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 24.02.2025*

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Tani në lidhje me subjektin unë mendoj që si Kuvend ne kemi mbajtur të njëjtën formë të vendimit edhe vendimi e ka përcaktuar zonzjën Spiropali, Kryetare e Kuvendit si subjekt dhe ne në të njëjtën formë kemi pasqyruar te parashtrimet.

**Z. I. Rusmali:** Nuk po e diskutojmë, nuk po ju vëmë me faj.

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Jo nuk ka problem.

**Z. I. Rusmali:** Nuk jemi duke thënë keni bërë gabim fare, jemi duke thënë për racionalitetin e kësaj procedure është më mirë të mos kemi të përfshirë subjekte që nuk kanë lidhje me çështjen, përveç rastit kur ju doni që t'i përfshini, me kërkesën tuaj ankimore, ky është diskutimi që po bëj.

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Në lidhje me objektin, për sa kohë me Inën kemi biseduar pikërisht përpara fillimit të kësaj seance dhe unë me thënë të drejtën nuk është se jam në dijeni të ndreqjeve të bëra dhe për sa kohë vendimi mund të jetë rregulluar, tani edhe ne besoj që e kemi atë mirëkuptim midis nesh nëse vendimi i publikuar në faqen e KQZ-së është i rregulluar, pra nuk e përmban pikën 2 dhe gjithashtu në arsyetim të tij nuk i përmban më referencat tek projektligji tjetër, pastaj jemi në kushtet që t'i qëndrojmë të njëjtit objekt, sikurse është parashtruar ditën e premte.

**Z. I. Rusmali:** Pra nuk modifikoni objektin?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Nëse jemi në këto kushte dhe nëse vendimi, realisht nuk e kam parë vendimin por, po marr të mirëqenë kolegen.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, ju keni mundësi ta verifikoni këtë gjë, vendimet janë të publikuara në faqen e internetit, por gjithsesi kopjen e zbardhur mund ta merrni nga Ina. Një pyetje për Inën.

**Z. L. Braho:** Ina kam një pyetje për këtë vendimin që keni korrigjuar, si bëhet korrigjimi si rregull? Pra del një vendim i ri për ndreqje vendimi apo thjesht hidhni në faqe atë të saktin?

**Znj. I. Osmanaj:** Kjo kishte ngelur thjesht, ishte një gabim material që u kap, domethënë në momentin që u dërgua për publikim u kap si gabim material por nuk është se bëmë një akt ose një shkresë, thjesht e bëmë korrigjimin dhe vumë në dijeni Kuvendin për këtë gjë, kemi folur me Drejtoreshën Juridike të Kuvendit. Por nuk bëmë një akt sepse kishte ngelur te pika 2 e dispozitivit, në brendësi akti nuk ndryshohej, vetëm te pika e dispozitivit kishte ngelur “Për paketën e maleve”, por që nuk e bëmë me një akt sepse u kap shumë shpejt.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Do e lëmë kështu pra, shihni çfarë mund të bëni, ju lutem shumë silleni me firmën e Kryetares së Kuvendit kërkesën ankimore që të mund të jemi në rregull me të gjithë elementët e formës dhe na jepni mundësinë që ta shqyrtojmë në themel nesër në ora 12.00? Nesër në 12.00 ne do të shohim edhe plotësimin e këtyre kërkesave që ne thamë dhe në qoftë se janë plotësuar kërkesat ne marrim vendimin për shqyrtimin dhe bëjmë dhe shqyrtimin.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 24.02.2025*

**Znj. A. Veshi, përfaqësuese e Kuvendit:** Nuk jam e sigurt nëse Kryetarja e Kuvendit, zonja Spiropali do të ndodhet në Shqipëri për të rifirmosur autorizimin, nuk e di nëse është e mundur për shkak edhe të ngarkesës suaj si mund të konkludojmë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk ka asnjë problem, ju afatin e ankimit e keni kapur me këtë kërkesë, në qoftë se nuk është e mundur që të firmoset nga Kryetarja e Kuvendit ne do të shtyjmë kohën tonë, një javë, dhjetë ditë, sa të jetë, pa asnjë problem. Jemi dakord? Në qoftë se na vjen informacioni që nuk është e mundur që të bëhet sot për sot kjo gjë do ta shtyjmë me dhjetë ditë shqyrtimin ose nesër në orën 12.00 plotësohet kërkesa dhe ne ecim përpara, ose përndryshe në qoftë se nuk është e mundur të plotësohet kërkesa do ta shtyjmë një javë, dhjetë ditë. Do të komunikojmë me njëri-tjetrin. Mirë, e ndërpresim këtu këtë seancë, do ta mbyllim seancën paraprake, nesër pasi të bëjmë verifikimin e plotësimit të këtyre elementëve. Faleminderit për pjesëmarrjen!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

